

Dafina Olluri është Zëvendës Drejtore në Open Data Kosova (ODK) dhe është përgjegjëse për një gamë të gjerë aktivitetesh brenda organizatës. Detyrat e saj përfshijnë përmbyshjen e qëllimeve strategjike të ODK-së, monitorimin e zbatimit të projekteve në vazhdim, krijimin e partneriteteve të reja, dhe sigurimin që të gjitha produktet përfundimtare të përmbyshin standardet e cilësisë së organizatës.

Dafina në vitin 2018 është vlerësuar me çmimin Forbes 30-nën-30 për punën e saj në Open Data Kosovo, e cila njohu organizatën si një nga nismat më të suksesshme për kontributin e dhënë në përmirësimin e Ligjit dhe Politikë bërjes në Evropë.

Dafina ka studiuar Ekonomi dhe Politika Publike në Bachelor dhe tani ka përfunduar Masterin në Informatikën e Biznesit. Ajo beson se një fokus i veçantë duhet të vendoset në zhvillimin e aftësive teknike të rinjëve Kosovare dhe vazhdimisht përpiqet të kontribuojë në përmirësimin e shoqërisë dhe të ndihmojë bashkëmoshatarët e saj të arrijnë qëllimet e tyre. Dafina është e përkushtuar për të bërë ndryshime shoqërore që përmirësojnë jetën e përditshme të bashkëqytetarëve, veçanërisht tek vajzat, përmes përdorimit të teknologjisë.

Në vitin 2019 fitoj një bursë nga Departamenti i Shtetit të SHBA-së në Programin Ndërkombëtar të Lidërsipit të Vizitorëve (IVLP) të quajtur "Hidden No More" - program që ftoi 48 gra udhëheqëse nga 48 vende të ndryshme - ku të gjitha punojnë në fushat e shkencës, teknologjisë, inxhinierisë dhe matematikës (STEM) - për të vizituar në Shtetet e Bashkuara për të rritur dhe eksploruar politikën që promovojnë interesat e grave në STEM.

Në të kaluarën, Dafina fitoj një bursë studimore brenda Programit të Zhvillimit Profesional për Ballkanin Perëndimor - Liderët për të Ardhmen ku u angazhua të punoj në Bruksel. Para angazhimit të saj në ODK, ajo ka punuar në Ministrinë e Punëve të Jashtme si konsulente e kontraktuar nga Këshilli Britanik, në kuadër të projektit "Kosova flet BE".